



*Mbështetja e integritetit mjedisor dhe
mekanizmave të konsultimit publik në
politikat dhe projektet e qeverisjes qendrore
dhe vendore*

Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë

Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë

Bulevardi "Ismail Qemali", Lagja "Pavarësia", Kulla e Ferhatit, Kati VII, Vlorë, Shqipëri.
Tel/Fax: +355 33 400182/ E-mail: aicvlore@gmail.com / Web Page: www.aic-vlore.org
Face book: Qendra e Informacionit Aarhus Vlore

Parathënie

Ky raport vlerësimi i përgatitur nga Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë, synon të pasqyrojë në mënyrë të përgjithëshme, gjendjen aktuale dhe kapacitetet në fushën e Energjive të Rinovueshme në njësitë vendore të Orikumit, Himarës, Lukovës, Sarandës dhe Ksamilit. Gjithashtu ky raport ka si qëllim pasyrimin e gjetjeve dhe paraqitjen e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e politikave vendore qoftë në zhvillimin e Energjisë së Rinovueshme si dhe nxitjen e pjesëmarrjes publike në hartimin e politikave dhe programeve në këtë fushë.

Duke marrë në konsideratë faktin që burimet e Energjisë së Rinovueshme janë të shumta në njësitë vendore të sipërpërmendura synohet që ky raport të ndihmojë palët e interesuara për ta përdorur atë si një referencë në programet dhe në projektet e mundëshme që mund të zbatohen në këtë zonë nga donatorë të ndryshëm publikë/privat, vendas/të huaj në fushën e Energjive të Rinovueshme.

Mendimet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë publikim janë tërësisht mendime dhe qëndrime të autorëve që kanë bërë të mundur realizimin e tij dhe nuk shprehin mendimet dhe qëndrimet e donatorit të projektit (Organizata për siguri dhe Bashkëpunim në Europë, Prezenca në Shqipëri).

Tabela e përmbajtjes

Falenderime.....	4
Hyrje.....	5
Metodologjia.....	7
Kuadri Ligjor.....	8
Energjia e Rinovueshme – koncepti dhe zhvillimi.....	12
Ç’është Energjia e Rinovueshme.....	12
Energjia e Rinoveshme në Botë.....	14
Shqipëria dhe Energjia e Rinoveshme.....	15
-Energjia e diellit.....	16
-Energjia e erës.....	17
-Biomasa.....	18
-Energjia gjeotermale.....	18
Vlerësimi i politikave lokale për zhvillimin e ER.....	20
-Takime me qytetarët.....	20
-Krijimi i KKQV (Komisionet Këshillimore Qytetare Vendore).....	20
-Tryeza të rrumbullakëta.....	22
Gjetjet.....	24
Rekomandime.....	25
Bibliografia.....	28

Falenderime

Për realizimin e këtij projekti është punuar gjatë një periudhe 5 mujore, Gusht – Dhjetor 2013 nga përfaqësuesit e Organizatës, “Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë” në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarë lokalë të Bashkive Orikum, Himarë, Sarandë dhe të Komunave Lukovë e Ksamil. Një kontribut shumë i çmuar është dhënë nga kryetarët e këtyre Institucionve: z. Gezim Capoj, z. Jorgo Goro, z. Stefan Cipo, z. Vladimir Kumi dhe z. Besnik Abedini.

Gjithashtu një falenderim i veçantë shkon për N/Kryetarët e Bashkive dhe Komunave, për Kryetarët e Këshillit Bashkiak/Komunal dhe Këshilltarët e tyre.

Falenderojmë gjithashtu qytetarët e këtyre Bashkive dhe Komunave që u treguan të gatshëm të ndajnë me ne shqetësimet e tyre, por edhe të paraqesin sugjerime dhe ide konkrete se si mund të përmirësohen shërbimet e ofruara nga Bashkitë dhe Komunitetët për të ruajtur një mardhënie të shëndetëshme me përfaqësuesit lokal dhe të rrisin bashkëpunimin midis tyre për çështje të ndryshme që shqetësojnë komunitetin në tërësi dhe për zhvillimin e Energjive të Rinovueshme në përgjithësi.

Falenderojmë për bashkëpunimin UNDP – prezenca në Shqipëri dhe znj. Mirela Kamberi, Agjensinë kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), z. Artan Leskoviku si edhe Ministrinë e Industrisë dhe të Energjitikës të përfaqësuar nga z. Agim Begasi dhe median lokale për pasqyrimin që i bëri të gjitha aktivitetet e këtij projekti.

Dhe padyshim që falenderimi më i madh shkon për OSBE – prezenca në Shqipëri të cilët mundësuan realizimin e këtij projekti, falë përkushtimit dhe këmbënguljes së tyre për të inkurajuar dhe mbështetur të gjithë aktorët lokal për të rritur bashkëpunimin e tyre për çështje të rëndësishme në tërësi dhe qoftë për zhvillimin e Energjive të Rinovueshme në veçanti.

Hyrje

Realizimi i projektit: ***“Mbëshetja e integritit mjedisor dhe të mekanizmave të konsultimit publik në politikat dhe projektet e qeverisjes qendrore dhe vendore”*** është realizuar dhe zbatuar nga Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë falë përkrahjes financiare dhe asistencës së OSBE – prezenca në Shqipëri, dhe me bashkëpunim me UNDP – prezenca në Shqipëri, Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyror (AKBN), Ministria e Industrisë dhe Energjitikës dhe Njësitë Vendore të Orikumit, Himarës, Lukovës, Sarandës dhe Ksamilit.

Një nga arsyt kryesore që shërbeu si indikator për zbatimin e këtij projekti ka qenë fakti që jetojmë në një vend i cili të ofron të gjitha mundësitë për shfrytëzimin e Energjisë së Rinovueshme por që fatkeqësisht prioriteti për këto energji ka qenë i pakonsiderueshëm. Ky projekt është realizuar në kuadër të informimit, ndërgjegjësimit dhe rritjes së bashkëpunimit të Qeverisjes Lokale me të gjitha grupet e interesuara, qofshin këta qytetarë, ambientalistë, grupet e biznesit apo shoqëri civile lokale, në saj të inkurajimit të zhvillimit të Energjive të Rinovueshme dhe të gjithë formave të tyre të ofruara në këto pesë Bashki dhe Komuna të përfshira në projekt.

Qëllimet e projektit

- Ndërgjegjësimi publik i qytetarëve për të bërë të mundur që komuniteti të marrë pjesë në mënyrë aktive në proceset konsultative mbi planifikimin dhe zhvillimin e energjisë së rinovueshme në nivel lokal duke i dhënë përparësi pjesëmarrjes publike;
- Inkurajimi dhe të mbështetja e dialogut midis të zyrtarëve të qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat në nivel lokal, mbi zhvillimin e iniciativave për energjinë e rinovueshme përmes përforcimit të mekanizmave të pjesëmarrjes publike;
- Konsistimi i dialogut në faktin që politikat e zhvillimit lokal në përgjithësi dhe ato të energjisë së rinovueshme në veçanti nuk janë vetëm çështje të thjeshta

teknike për inxhinierë dhe zyrtarët publikë, por janë projekte zhvillimi në favor të gjithë komunitetit dhe si të tilla duhet të zbatohen e te kalojnë përmes një proçesi të gjerë publik me pjesëmarrjen e shumë aktorëve dhe grupeve të ndryshme të interesit në nivelo lokale.



Metodologjia

Shqyrtimi i dokumentave. Stafi i projektit ka shqyrtuar dokumentat e vëna në dispozicion nga Bashkitë dhe Komunat përkatëse në fushën e energjisë së rinovueshme. Këto dokumenta kanë konsistuar në broshura të thjeshta dhe projekte konkret të zbatuar nga donatorë në bashkëpunim me njësinë vendore përkatëse.

Intervista. Në kuadër të këtij projekti, përfaqësuesit e organizatës, kanë realizuar intervista me qytetarë, përfaqësues të biznesit, të rinjë, gra, këshillëtarë dhe zyrtarë lokal, për t'u njohur nga afër me njohuritë që kanë këta përfaqësues në fushën e energjive të rinovueshme dhe mendimet e idetë për zhvillimin e tyre, e parë kjo nga këndvështrimi i grupeve të ndryshme të interesit. Qytetarët e intervistuar janë përzgjedhur duke marrë në konsideratë gjithpërfshirjen e të gjitha grupeve të interesit si dhe duke respektuar barazinë gjinore. Janë intervistuar gjithësej 53 persona në të pesta njësitë vendore nga të cilat 26 kanë qënë gra dhe vajza. Proçesi i intervistimit ka zgjatur pak më tepër se parashikimi për vetë faktin se është dashur që shumë qytetarë të informohen më tërë në lidhje me konceptin e Energjisë së Rinovueshme dhe rolin që mund të luajnë grupet e ndryshme të interesit në këtë proçes. Të gjithë të intervistuarit kanë treguar interes dhe janë treguar të gatshëm për të bashkëpunuar gjatë realizimit të aktiviteteve në kuadër të projektit.

Takime me komunitetin. Në kuadër të projektit janë realizuar gjithsej 10 takime, në 5 njësitë vendore të Qarkut Vlorë. Takimet janë organizuar në formën e diskutimeve për krijimin e një strukture të qëndrueshme qytetare me përfaqësues nga komuniteti e cila do të shërbejë për të forcuar bashkëpunimin midis qytetarëve dhe pushtetit lokal për një vendim-marrje sa më demokratike.

Nisma e krijimit të Komisioneve Këshillimore Qytetare Vendore (KKQV) është pritur me mjaft inters nga qytetarët dhe grupet e interesit duke e parë këtë nisëm si një mundësi reale që qytetarët kanë për të shprehur mendimet, sygjerimet dhe idetë e tyre pranë njësive vendore përkatëse për plane, programe dhe projekte që synojnë zhvillimin e zonës.

Sigurisht që kjo është një përjasje e re e cila synon që të rritet bashkëpunimi institucional midis qytetarëve dhe zyrtarëve lokalë, duke sjellë në vëmendje të tyre çështje shqetësuese për qytetarët në përgjithësi dhe për çështjet e Energjisë së Rinovueshme në veçanti.

Takime me përfaqësues të Bashkive/Komunave dhe këshillëtarëve. Në të pestë njësitë vendore të qarkut Vlorë ku është realizuar projekti janë organizuar takime me përfaqësues të njësive vendore përkatëse dhe këshillëtarëve. Këto takime kanë synuar që përveçse të diskutohej programi i projektit, të prezantohej dhe nisma e krijimit të Komisioneve Këshillimore Qytetare Vendore, si një iniciativë që do të forcojë bashkëpunimin midis njësisë vendore, këshilltarëve Bashkiakë/Komunal dhe qytetarëve e grupeve të interesit për rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit në proçeset vendim-

marrëse, e sidomos për projektet që kanë ndikim në mjedis. Në këto takime është diskutuar gjithashtu kontributi që mund të ofrojë Bashkia/Komuna përkatëse për funksionimin normal të këtyre komisioneve dhe është rënë dakort që të nënshkruhet një Marrëveshje Mirëkuptimi midis Koordinatorit/es dhe Kryetarit/es të Bashkisë/Komunës.

Tryezat të rrumbullakëta. Janë realizuar pesë tryeza të rrumbullakëta, një në çdo njësi vendore të përfshirë në projekt. Pjesëmarrësit në këto tryeza të rrumbullakëta kanë qënë përfaqësues të OSBE, UNDP, AKBN, të njësive vendore, këshillëtarë, përfaqësues të biznesit, përfaqësues të KKQV, gra dhe të rinjë. Qëllimi i tryezave ishte diskutimi i rrugëve dhe mjeteve efikase për zhvillimin e Energjisë së Rinovueshme në këto zona duke përshtatur legjislacionin kombëtar në nivel vendor dhe duke rritur bashkëpunimin midis pushtetit lokal dhe komunitetit nëpërmjet strukturës së KKQV. Të pranishmit në këto tryeza vlerësuan iniciativën si shumë të nevojshme në kohën e duhur për të shfrytëzuar kapacitetet dhe burimet e shumta të ER në këtë zonë si dhe theksuan rëndësinë e KKQV-së për të realizuar procesin e realizimit të projekteve në këtë fushë tërësisht me pjesëmarrjen e publikut, grupet e interesit të biznesit si një domosdoshmëri dhe garanci për zhvillimin e qëndrueshëm.

Kuadri Ligjor për Energjinë e Rinovueshme

LIGJ Nr. 138/2013 për Burimet e Energjisë së Rinovueshme

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të ndihmojë në përdorimin ekonomik të burimeve natyrore dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë;
- b) të nxisë përdorimin e teknologjive dhe novacioneve për prodhimin e energjisë elektrike dhe nxehtësisë nga burime të rinovueshme energjie, për të siguruar një Zhvillim të Qëndrueshëm të vendit;
- c) të zvogëlojë importin e lëndëve djegëse organike, të zvogëlojë gazet me efekt serrë dhe të mbrojë mjedisin, në zbatim të detyrimeve Ndërkombëtare të Republikës Shqipërisë nga marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare të energjisë;
- ç) të rrisë llojshmërinë e përdorimit të burimeve të energjisë dhe sigurinë e furnizimit me energji në Republikën e Shqipërisë;
- d) të nxisë zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë dhe integrimin e tij në atë rajonal;
- dh) të rrisë numrin e prodhuesve të pavarur të energjisë dhe të nxitë zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme;
- e) të nxisë zhvillimin rural dhe të zonave të izoluar, duke përmirësuar furnizimin me energji të këtyre zonave.

Ky ligj është përafruar plotësisht me:

Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 prill 2009: "Mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga Burime të Rinovueshme, si dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE". Numri CELEX: 32009L0028, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 140, datë 5. 6. 2009, faqe 16 - 62.

LIGJ Nr. 9379, datë 28.4.2005 për Efiçencën e Energjisë

Qëllimi i këtij ligji është hartimi i kuadrit ligjor të nevojshëm për nxitjen dhe përmirësimin e efiçencës së përdorimit të energjisë gjatë gjithë ciklit.

Objekti

Ky ligj përcakton mënyrën e përdorimit ekonomik të burimeve të energjisë, krijimin e kushteve të qëndrueshme të furnizimit me energji, si dhe uljen e ndikimit të dëmshëm në mjedis.

VKM Nr. 584 dt. 2.11.2002 për Kursimin e Energjisë dhe Ruajtjen e Ngrohtësisë në Ndërtime

1. Të gjitha objektet, që do të ndërtohen për banim, si dhe ndërtimet publike a private detyrohen të vendosin në ndërtesa instalimet e ngrohjes qendrore vendore ose individuale.
2. Burimet Energjetike, që do të përdoren për ngrohje, të jenë me lëndë djegëse organike, të ngurta, të lëngta dhe të gazta. Në asnjë rast sistemet e ngrohjes nuk duhet të parashikojnë përdorimin e energjisë elektrike.

LIGJ Nr. 8937, date 12.9.2002 për Ruajtjen e Nxehtësisë në Ndërtesa

Ky ligj ka për qëllim të krijojë bazën ligjore të nevojshme për vendosjen e rregullave dhe bërjen të detyrueshme të marrjes së masave për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa.

LIGJ Nr.9379, datë 28.4.2005 për Efiçencën e Energjisë

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është hartimi i kuadrit ligjor të nevojshëm për nxitjen dhe përmirësimin e efiçencës së përdorimit të energjisë gjatë gjithë ciklit.

Objekti

Ky ligj përcakton mënyrën e përdorimit ekonomik të burimeve të energjisë, krijimin e kushteve të qëndrueshme të furnizimit me energji, si dhe uljen e ndikimit të dëmshëm në mjedis.

Politika e Efiçencës së Energjisë

Objektivat e nxitjes së efiçencës së energjisë

Objektivat e politikës për përdorimin me efiçencë të energjisë, si pjesë përbërëse e gjithë

politikës së energjisë, kanë të bëjnë, kryesisht, me rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, nëpërmjet uljes të konsumit të burimeve energjetike dhe të ndotjes së mjedisit.

LIGJ 10113 “Për Treguesit e Konsumit të Energjisë dhe Burimeve të tjera nëpërmjet etiketimit dhe informacioni standard të produkteve me ndikim në energji”

Objekti

Ky ligj përcakton detyrimet për informimin e përdoruesve të fundit mbi konsumin e energjisë dhe sipas rastit burimeve të tjera kryesore të produkteve që gjatë përdorimit të tyre kanë ndikim në konsumin e energjisë. Ky informacion sigurohet veçanërisht nëpërmjet etiketimit, informacionit standard dhe informacionit plotësues, duke i mundësuar përdoruesit të fundit zgjedhjen e produkteve më efiçente.

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për produkte që gjatë përdorimit kanë një ndikim të rëndësishëm të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi konsumin e energjisë dhe, sipas rastit, mbi burimet e tjera kryesore.
2. Ky ligj nuk zbatohet për:
 - a) produkte të përdorura;
 - b) çdo mjet transporti për persona ose mallra;
 - c) pllakëzat që tregojnë parametrat e produktit ose të njëvlershmet e tyre të fiksuara në produkt për qëllime të sigurisë.

LIGJ Nr. 138/2013 për Burimet e Energjisë së Rinovueshme*

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të ndihmojë në përdorimin ekonomik të burimeve natyrore dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë;
- b) të nxitë përdorimin e teknologjive dhe novacioneve për prodhimin e energjisë elektrike dhe nxehtësisë nga burime të rinovueshme energjie, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të vendit;
- c) të zvogëlojë importin e lëndëve djegëse organike, të zvogëlojë gazet me efekt serrë dhe të mbrojë mjedisin, në zbatim të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës Shqipërisë nga marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare të energjisë;
- ç) të rritë llojshmërinë e përdorimit të burimeve të energjisë dhe sigurinë e furnizimit me energji në Republikën e Shqipërisë;
- d) të nxitë zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë dhe integrimin e tij në atë rajonal;
- dh) të rritë numrin e prodhuesve të pavarur të energjisë dhe të nxitë zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme;
- e) të nxitë zhvillimin rural dhe të zonave të izoluara, duke përmirësuar furnizimin me energji të këtyre zonave.

* Ky ligj është përafruar plotësisht me:

Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 23 prill 2009: “Mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga Burime të Rinovueshme, si dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE”. Numri CELEX: 32009L0028, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, Nr. 140, datë 5. 6. 2009, faqe 16 – 62.3500.

Energjitë e Rinovueshme – koncepti dhe zhvillimi

Ç'është Energjia e Rinovueshme???

Energjia e Rinovueshme është një term i përcaktuar politikisht për burimet e energjisë. Energjia e Rinovueshme është përcaktuar në përgjithësi si energjia që vjen nga burime të cilat janë të vazhdueshme si: rrezatimi diellor, era, shiu, valët e detit dhe baticat, biomasa dhe ngrohja gjeotermale.

Rreth 16 % i konsumit global të energjisë vjen nga burimet e rinovueshme, 10% e energjisë vjen nga biomasa tradicionale, e përdorur kryesisht për ngrohje dhe 3.4% nga hidroelektriciteti. Burimet e rinovueshme të reja (të tilla si, biomasa, era, rrezatimi diellorë, biokarburantet dhe enregjia gjeotermale) llogariten që aktualisht të jenë rreth 3% dhe po rriten me shpejtësi. Pjesa e energjive të rinovueshme në gjenerimin e energjisë elektrike është rreth 19%, ku 16% e energjisë elektrike vjen nga energjia hidrike dhe 3% nga burimet e ripërtëritshme të reja. Shumë projekte të Energjisë së Rinovueshme janë me shkallë të gjerë pasi teknologjitë janë të përshtatshme edhe për zonat rurale dhe të largëta, ku energjia është shpesh vendimtare në zhvillimin njerëzor.

Pjesa dërmuese e energjisë së rinovueshme vjen në mënyrë të drejtpërdrejte ose jo të drejtpërdrejte nga dielli. Rrezet e diellit ose energjia diellore, mund të përdoren në mënyrë të drejtpërdrejtë për ngrohje ose ndriçimin e banesave apo të ndërtesave të tjera, për të prodhuar energji elektrike, për ngrohjen e ujit, ftohjen diellore dhe për një sërë përdorimesh të tjera tregtare dhe industriale.

Nxehtësia e diellit gjithashtu ndikon tek era energjia e së cilës kapet nëpërmjet turbinave. Me pas, era dhe nxehtësia diellore bëjnë që uji të avullojë. Kur ky avull uji kthehet në shi apo në dëborë dhe rrjedh nëpër lumenj dhe përrenj, fuqia e tij, hidroenergji, mund të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike. Së bashku me shiun dhe boren, rrezet e diellit ndikojnë në rritjen e bimëve. Lënda organike që mundëson këtë rritje quhet biomasë. Biomasa gjithashtu mund të përdoret për të prodhuar elektricitet, karburant transporti apo kimikate. Përdorimi i biomasës për secilin nga këto qëllime është quajtur bioenergji.

Hidrogjeni mund të gjendet gjithashtu në disa përbërje organike si edhe në ujë. Ai është elementi që gjendet në sasi të madhe në Tokë por ai nuk mund të gjendet në gjendje të lirë si gaz. Ai kryesisht gjendet i kombinuar me elementë të tjerë, si p.sh në ujë i kombinuar me oksigjenin. Nëse ndahet nga elementet e tjerë ai mund të digjet si karburant apo të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike. Jo të gjitha burimet e rinovueshme të energjisë vijnë nga dielli.



Figura 1. Energjia e gjeneruar nga uji, nga era dhe nga dielli

Energjia gjeotermale, apo energjia që vjen nga ngrohja e brendshme e tokës mund të përdoret në mënyra të ndryshme, përfshirë këtu prodhimin e energjisë elektrike si edhe në sistemet e ngrohjes dhe të ftohjes së ndërtesave. Edhe energjia e rrymave oqeanike vjen nga tërheqja gravitacionale e hënës dhe diellit në Tokë.



Figura 2. Energjia e gjeneruar nga valët e detit (dhe baticat), biomasa dhe gjeotermaliteti i tokës

Në fakt energjia oqeanike vjen nga shumë burime. Përveç energjisë së baticës, ekziston edhe energjia e valëve të oqeanit, të cilat shtyhen si nga rrymat dhe erërat. Dielli ngroh gjithashtu sipërfaqen e oqeanit me shumë se në brendësi të tij duke krijuar kështu një ndryshim temperature e cila mund të përdoret si burim nxehtësie. Të gjitha këto forma të energjisë së oqeanit mund të përdoren për prodhimin e elektricitetit.

Energjia e rinovueshme është e rëndësishme për shkak të përfitimeve që ajo ofron. Përfitimet kryesore janë:

- **Përfitime mjedisore:** Teknologjitë e energjisë së rinovueshme janë burimet më të pastra të energjisë të cilat kanë ndikim të ulët në mjedis sesa teknologjitë e energjisë konvencionale.

- **Energji për brezat që do të vijnë:** Energjia e rinovueshme duhet të jetë gjithmonë në qendër të vëmendjes. Të tjera burime energjie janë duke u mbaruar dhe një dite edhe do të shterojnë.
- **Vende pune dhe ekonomi:** Shumica e investimeve në energjinë e rinovueshme janë kryer në materiale dhe në artin e ndërtimit dhe mirëmbajtjes sesa në drejtim të importeve të kushtueshme të energjisë. Investimet në energjinë e rinovueshme janë kryer zakonisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kryesisht në të njëjtin shtet dhe shpesh në të njëjtin qytet. Kjo do të thotë që paratë tuaja për energji qëndrojnë në shtëpi duke krijuar vende pune, për ekonomitë lokale të lëndëve djegëse, në vend që të dalin jashtë shtetit. Ndërkohë , teknologjitë e energjisë së rinovueshme të zhvilluara dhe të ndërtuara në SHBA janë duke u shitur jashtë shtetit duke siguruar kështu një nxitje për deficitin tregtar të SHBA-së.
- **Sigurimi i energjisë:** Pas ndërprerjeve të furnizimit me naftë të viteve 1970, populli ynë ka rritur varësinë e furnizimit me këtë produkt nga jashtë në vend që ta zvogëlojë atë. Kjo varësi në rritje ndikon me shumë në politikat kombëtare të energjisë.

Burimet e ER, energjia e të cilave derivon nga dielli në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthorazi, si energjia hidrike dhe era, mendohet të jenë të afta të furnizojnë me energji njerëzimin edhe për gati 1 miliard vjet, në këtë pikë rritja e parashikuar e temperatureve, rrjedhimisht edhe e nxehtësisë së rrezatuar nga dielli pritet të bëjë sipërfaqja e Tokës shumë të nxehtë kështu që uji nuk do mund të ekzistoj në gjendje të lëngshme.

Energjia e Rinovueshme së Botë

Sipas Agjensisë Ndërkombëtare të Energjisë, energjia e Erës është me një rritje në normë prej 30% në vit, me një kapacitet të instaluar prej 282.482 megavat (MW) në mbarë botën deri në fund të vitit 2012. Kjo energji është përdorur gjerësisht në Evropë, Azi dhe Shtetet e Bashkuara. Në fund të vitit 2012 kapaciteti fotovoltarik (PV) në mbarë botën ishte 100.000 MW, dhe termocentralet PV më të njohura janë në Gjermani dhe Itali. Stacionet e energjisë termike diellore veprojnë në SHBA dhe Spanjë, dhe më i madh i këtyre është 354 MW, centrali SEGS në shkretëtirën Mojave. Instalimi më i madh gjeotermik në botë është Geysers në Kaliforni, me një kapacitet nominal prej 750 MW. Brazili ka një nga programet më të mëdha të Energjisë së Rinovueshme në botë, që përfshin prodhimin e karburantit të etanolit nga kallami i sheqerit, dhe tani ofron etanol në 18% të karburantit të automobilave të vendit . Karburantit Etanol është gjithashtu gjerësisht i përdorur në SHBA .

Burimet e ER ofrojnë mundësit të mëdha për eficiencën e energjisë, këto mundësi ekzistojnë mbi sipërfaqe të gjera gjeografike, në kontrast me burimet te tjera të energjisë, të cilat janë të përqendruara në një numër të kufizuar vendesh. Me vendosjen e shpejtë të ER dhe efikasitetin energjitik, teknologjik dhe diversifikimin e burimeve të reja të saj, do të rezultojë në sigurimin e energjisë dhe përfitime ekonomike të konsiderueshme.

ER zëvendëson karburantet konvencionale në katër fusha të ndryshme: energji elektrike, ujin e nxehtë, lëndëve djegëse motorike dhe shërbimet e tjera energjetike.

Prodhimi i energjisë elektrike. ER siguron 19% të gjenerimit të energjisë elektrike në të gjithë botën. Gjeneratorë ER janë të shpërndarë në shumë vende, dhe netëm energjia e erës tashmë siguron një pjesë të konsiderueshme të energjisë elektrike në disa fusha: për shembull, 14 % në shtetin amerikan të Iowa, 40 % në shtetin verior gjerman i Schleswig-Holstein, dhe 49 % në Danimarkë. Disa vende marrin pjesën më të madhe të energjisë së tyre nga burimet e rinovueshme, përmendim: Islandën (100 %), Norvegjinë (98 %), Brazilin (86 %), Austrin (62 %), Zelandën e Re (65 %), dhe Suedin (54 %).




Figura 3. Grafiku i Kapacitetit Global të ER

Në nivel ndërkombëtar, të paktën 30 vende rreth botës tashmë kanë Energji të Rinovueshme me kontribut të konsiderueshëm, kjo më shumë se 20% të furnizimit me energji. Tregjet kombëtare të ER janë të parashikuara të vazhdojnë të rriten fuqishëm në dekadat e ardhshme dhe më gjerë, rreth 120 vende kanë objektiva të ndryshme në politikat afatgjata për aksionet e energjisë së rinovueshme, duke përfshirë edhe një objektiv prej 20% të të gjithë energjisë së prodhuar për Bashkimin Evropian deri në vitin 2020. Disa

vende kanë objektiva edhe më të larta për periudha afatgjata në zëvendësimin e energjisë në 100%. Jashtë Evropës, një grup prej prej 20 vendesh synon që aksionet e ER për vitet 2020-2030 të variojnë nga 10% në 50%.

Ndryshimi i klimës dhe shqetësimet e ngrohjes globale, të shoqëruara me çmimet e larta të karburanteve, janë ngarje të cilat çojnë në rritjen e politikave të legjislationit të ER. Sipas një projeksion te vitit 2011 nga ana e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë, gjeneratorët e energjisë diellore mund të prodhojnë

shumicën e energjisë elektrike në botë brenda 50 viteve, duke zvogëluar dramatikisht emetimet e gazeve serë që dëmtojnë mjedisin.

Shqipëria dhe Energjia e Rinovueshme

Vendi ynë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për implementimin e direktivave të BE-së në Strategjinë Kombëtare të Energjisë lidhur me rregullat e përbashkëta për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë dhe promovimi i prodhimit dhe konsumit të energjisë të prodhuar prej burimeve të rinovueshme.



Figura 4. Historiku i prodhimit vendas të energjisë elektrike 1982-2013 (GWh)

Shqipëria po punon për një sektor energjie të besueshëm dhe të qëndrueshëm, zhvillim i të cilit do të jetë i bazuar në shfrytëzimin e të gjitha opsioneve të energjisë në mënyrë që të plotësojmë nevojat tona për energji dhe për të krijuar vlerë të shtuar për qytetarët e Shqipërisë, në përputhje me parimet e përgjegjësisë mjedisore, ekonomike dhe sociale.


Qeveria e Republikës së Shqipërisë luan një rol kyç në krijimin e një ambienti stimulues për investime në strukturën e energjisë, veçanërisht për kapacitetet e reja të prodhimit dhe në uljen e rrezikut për investitorët me anë të aktiviteteve të saj dhe kuadrit transparent, të qartë dhe të qëndrueshëm të politikave strategjike.

Aktualisht energjia e përdorur gjerësisht në Shqipëri është ajo hidrike.

Por përveç burimeve potenciale në shfrytëzim, Shqipëria ka një potencial të konsiderueshëm hidrik për të ndërtuar edhe HEC-e të reja. Në lumin Drin janë propozuar për tu konsideruar si një kapacitet i ri për të ardhmen e afërt HEC Ashta (48 MW); Skavica I-80 MW; Skavica II-80 MW, në lumin Vjosa rreth 9 (nëntë) HEC-e të mesëm dhe të mëdhenj me një kapacitet total të instaluar prej 385 MW duke përfshirë dhe HEC-in e Kalivaçit, në lumin Devoll HEC-e të mesme dhe të mëdhenj me një kapacitet total të instaluar prej 270 MW. Analizat e ndryshme tregojnë që kapaciteti i

Energjia Diellore

Shqipëria është e pozicionuar në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, në pjesën lindore të detit Adriatik dhe Jon. Në Shqipëri rrezatimi diellor mesatar është 1500 kWh/m^2 në vit dhe rrezatimi maksimal është 2200 kWh/m^2 në vit. Për sa i përket diellëzimit vjetor për të gjithë territorin e shqipërisë kap shifrat prej 2200 orësh në vit, ndërkohë që diellëzimi në pjesën perëndimore dhe jugperëndimore të Shqipërisë është rreth 2600 orë në vit. Në 2012, në Shqipëri janë instaluar 7000 njësi panele diellore, ku janë instaluar (60% në sektorin e shërbimit, 40% në sektorin e banesave), sipërfaqja totale $35,000 \text{ m}^2$ (ekuivalent me 55 GWh/y ose 1.1% e energjisë elektrike që konsumohet në sektorin e banesave për vitin 2012).



Energjia e Erës

17

Aktualisht në Territorin e Shqipërise janë duke u bërë disa matje dhe studime për potencialin e energjisë së erës nga kompani të ndryshme si më poshtë:

- Parku Eolik Bilisht-Kapshticë (150 MW), i cili është i autorizuar të ndërtohet nga HERA shpk;
- Parku Eolik Shëngjin-Kodrat e Rencit në Lezhë (108 + 114 MW), i cili është i autorizuar të ndërtohet nga Albania Green Energy Itali;
- Projekt për Park Eolik në Karaburun të Vlorës me 500 MW të instaluar, që është në zhvillim nga MONCADA Itali;
- Projekti për Park Eolik Butrinti-Markat (72 MW), i cili është në zhvillim nga kompania E-Vento;
- Projekti për Park Eolik në Grykëderdhjen Shkumbini-Terpan (145 + 80 MW), i cili është në zhvillim e nga Alb-Wind-Energy;
- Parku Eolik në Kryevindh-Kavajë, i cili është në zhvillim e nga ERS-08 per 40 MW dhe nga Unione Eolika Albania për 150 MW.
- Shpejtesia mesatare e erës gjatë gjithë vitit është rreth 4-6 m/s (10 m lartësi), dhe densiteti mesatar vjetor 150 W/m^2 .




Figura 6. Shpejtësia mesatare vjetore e erës

Biomasa

Biomasa në Shqipëri është zhvilluar në mënyrë tradicionale (drutë e zjarrit dhe plehrat e thara të kafshëve). Drutë e zjarrit përdoren në oxhakët tradicional, boiler me dru zjarri, soba me dru dhe sisteme të vogla ngrohjeje të ngjashme. Në qoftë se do ti referoheshim totalit të rezervave drusore si lëndë djegëse në Shqipëri ato arrijnë rreth 6 Mtoe dhe ajo pjesë e shfrytëzuar për prodhimin e energjisë nga drutë e zjarrit për vitin 2012 ishte rreth 215 ktoe/vit.

Që në të ardhmen edhe përdorimi i Biomases te jetë efektiv dhe të zërë një vend të konsiderueshëm në prodhimin e Energjisë së Rinovueshme Shqipëtare, promovimi duhet të fokusohet në vendosjen e:

- Një kuadri ligjor të favorshëm,
- Detyrimeve mjedisore,

- Akteve të demonstrimit për të fituar eksperiencë dhe pranimi nga opinioni publik.

Që Biomasa të përdoret në mënyrë efikente duhet bërë një studim paraprakë për:

- Identifikimin e teknologjive të përshtatshme për përdorimin e biomases,
- Strukturën dhe ndryshimet e energjisë pas futjes së burimeve të ripërtëritshme të energjisë,
- Konsideratat ekonomike,
- Zhvillimin Kombëtar – krijimin e vendeve të punës.


Energjia Gjeotermale

Shqipëria, aktualisht është në një fazë vizibiliteti të vlerësimit të potencialit të energjisë gjeotermike. Por me siguri mund të themi se situata gjeotermike e Albaniteve paraqet dy drejtime kryesore:

- Burimet termike me entalpi të ulët;
- Përdorimi i thellësive të puseve të abandonuara.

Prodhiimi i energjisë së rinovueshme dhe tërheqja e investorëve sa më potenciale është një nga çështjet ku diplomacia ekonomike, diplomatët shqiptarë mund të punojnë me seriozitet. Prezantimi i këtyre vlerave me qartësi dhe saktësi padyshim që rrit akoma dhe më tej interesin e investuesit, por si kjo çështje janë me dhjetëra që kërkojnë trajtime sa më të plota. Sa më i plotë të jetë bashkëpunimi mes hallkave, sa më serioz të jenë materialet njohës dhe promovuese, aq më shumë do të sensibilizohen qarqet e biznesit, aq më shumë do të rritet interesi i tyre për të investuar në Shqipëri. Por këto drejtori perëndimore në çdo kohë duhet të mbeten të informuara për çdo detaj ekonomik, prioritetet, burimet, tendencat e zhvillimeve ekonomike.

Në kuadër të ndërgjegjësimit dhe të shpalosjes së mundësive të Zhvillimit të Energjive të Rinovueshme në Jug të Shqipërisë Qendra e Informacionit Aarhus ka implementuar projektin: “Mbështetja e integritimit mjedisor dhe mekanizmave të konsultimit publik në politikat dhe projektet e qeverisjes qendrore dhe vendore”.



Vlerësimi i politikave lokale për zhvillim e Energjive të Rinovueshme

1. Takim me qytetarët, grupet e interesit dhe zyrtarët lokal

Janë marrë kontakte me përfaqësuesit e shoqërisë civile, biznesmenët e zonave përkatëse dhe zyrtarëve lokal nga database i Qendrës së Informacionit Aarhus të krijuar nga projektet e realizuara në këto zona në punën disa vjeçare të saj. Ky takim i parë është zhvilluar me përfaqësuesit e shoqërisë civile, biznesmenët, grupet e interesit dhe me qytetarët në Bashkitë Orikum, Himarë, Sarandë dhe në Komunitet Lukovë e kësaj. Në këtë takim u prezantua ideja e krijimit të Komisioneve Këshillimore Qytetare Vendore, rolin që do të luajnë këto komisione si organe këshilluese pranë Këshillit Bashkiak dhe njësive të qeverisjes vendore, kush do të jetë në përbërje të tyre dhe si do të funksionojë kjo strukturë në funksion të dialogut mes qytetarëve dhe Bashkive dhe Komunave. Projekti fillimisht u prit me skepticizëm nga një pjesë e këshilltarëve të Bashkive/Komunave, pasi kjo strukturë u perceptua si një mbivendosje me Këshillin Bashkiak/Komunal. Gjithashtu pati paqartësi nga qytetarët për mënyrën se si do të funksiononte kjo strukturë dhe se sa bashkëpunuese do të jetë njësia vendore.

2. Krijimi i KKQV (Komisioneve Këshillimore Qytetare Vendore)

Komisionet Këshillimore Qytetare Vendore (KKQV) janë grupe vullnetare qytetarësh të cilat do të shërbejnë si organe këshillimore për Bashkitë dhe Komunitet. Ato janë gjithëpërfshirëse dhe të pavarura nga kontrolli prej njësisë vendore, me përfaqësim të gjerë me qytetarë që kanë vizion dhe duan të mundësojnë ndryshime pozitive në qytetin e tyre. Objektivat e krijimit të KKQV janë të shumta por shkurtimisht mund të themi se KKQV :

- Inkurajon përfshirjen e qytetarëve në qeverisjen vendore;
- Diskuton dhe artikulon çështje të rëndësishme të funksionimit të bashkisë;
- Konsulton zyrtarët dhe stafin e bashkisë me vizion dhe ide që vijnë nga shoqëria civile për përmirësimin e qeverisjes vendore;
- Krijon një mekanizëm përfshirës dhe me pjesëmarrje që qytetarët të mësojnë për qeverisjen vendore dhe të luajnë një rol aktiv duke dhënë kontributin e tyre.

Për sa i përket funksionimit të Komisioneve Këshillimore Qytetare vendore mund të themi se KKQV janë organe konsultative të Bashkisë të institucionalizuara me një

Marrëveshje Mirëkuptimi midis palëve, por duhet theksuar se kjo marrëveshje nuk ka bazë ligjore. KKQV-të janë grupime të përbërë nga rreth 20 vullnetarë me përfaqësim nga grupe të ndryshme të komunitetit. Këto grupime kanë përfaqësim të gjerë gjinor dhe gjeografik, me përfshirje të qytetarëve, të rinjve, OJQ-ve, bizneseve lokale, minoriteteve, etj. Midis anëtarëve të grupimeve është zgjidhur një person i cili do të shërbejë si koordinatorë midis Bashkisë/Komunës dhe anëtarëve të komisionit. KKQV ofron ide, mendime dhe sugjerime pranë Këshillit Bashkiak dhe zyrtarëve lokal për çështje të rëndësishme lokale që janë në interes të komunitetit dhe të zhvillimi të zonës duke qënë totalisht jo vendim-marrëse.

Duke filluar sipas një rendi kronologjik, takimet e kryera për krijimin e Komisioneve Këshillimore Qytetare Vendore ishin:



Komisioni Këshillimor Qytetar
Himarë – 25/09/2013:



Komisioni Këshillimor Qytetar
Orikum – 30/10/2013 Koordinatorë



Komisioni Këshillimor Qytetar
Ksamil/Sarandë – 02/10/2013;



Komisioni Këshillimor Qytetar
Lukovë – 03/10/2013 /

3. Tryeza të rrumbullakta

Si finalizim për projektin: “Mbështetja e integritit mjedisor dhe mekanizmave të konsultimit publik në politikat dhe projektet e qeverisjes qendrore dhe vendore”, u zgjodhë tryeza e rrumbullakët, kjo u realizua duke vënë përball përfaqësuesit e pushtetit vendor dhe atij qëndror, inxhinier dhe specialist të Energjive të rinovueshme, përfaqësues nga shoqëria civile si edhe përfaqësues nga të gjitha grupet e komunitetit lokal.



Tryeza e rrumbullakët Sarandë dhe
Ksamil: 30 Tetor 2013

Fillimisht ndaj auditorit u referuan përfundimet e një studimi të mirëfilltë mbi perceptimet lokale të potencialeve të zhvillimit të Energjive të Rinovueshme në jug nga znj. Valbona Mazreku. Përfundimet e studimit nxorrën në pah të metat për sa i përket legjislacionit dhe zbatimit të tij, punën e paktë informuese dhe ndërgjegjëse të komunitetit si edhe shfrytëzimin aktual sporadik dhe të

pakonsiderueshëm të energjive të Rinovueshme në këto zona.

Përfaqësuesi i Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore z. Artan Leskoviku, prezantoi dhe bëri të njohur legjislacionin aktual vendas, gjithmonë në fushën e Energjive të Rinovueshme si edhe një pasqyrim të shfrytëzimit të deritanishëm të këyre energjive. Pasqyrimi i plotë i situatës aktuale la të kuptohej se kontributi i Burimeve të Rinovueshme në Shqipëri është në masën 29.3%, masë shumë e vogël në krahasim me atë që ofrohet. M.gj.th edhe me mbështetjen ligjore edhe me politikat e planifikuara për të ndjekur, një sërë investimesh dhe projektsh do të implementohen në një të ardhme shumë të afërt.



Tryeza e rrumbullakët Himarë: 30
Tetor 2013

Gjithashtu një prej partnerve të këtij projekti znj. Mirela Kamberi përfaqësuese e United Nations Development Project (UNDP) paraqiti një sërë projektsh të implementura nga UNDP ne botë dhe Shqipëri si edhe aspektet teknike të nevojshme për efektivitetin e

tyre (kryesisht të paneleve diellore). Duke qenë në zbatim të një projekti, UNDP ofroi paisjen me panale diellore të një Institucioni Publik të ç'donjërës prej pesë Bashkive dhe komunave të përfshira në projektin e Qendrës së Informacionit Aarhus. Kjo bëri që projekti të mos ngelej vetëm në aspektin teorik/ndërgjegjësues/mbeështetës por gjithashtu në një aspekt praktik dhe lehtësues për institucione të ndryshme.

Këto prezantime bënë që të ftuarit të informoheshin rreth çështjes së Energjive të Rinovueshme dhe pas një diskutimi konstruktiv e të gjerë spikati interesimi dhe feedback-u pozitiv për shfrytëzimin e Energjive të Rinovueshme.



Tryeza e rrumbullakët Orikum: 15 Tetor 2013 dhe Lukovë: 17 Tetor 2013

Tryezat e rrumbullakëta u finizuan me shprehjen e Kryetarit të Bashkisë Sarandë: *“Jetojmë në një vend që e ka bekuar perëndia, e vërtetë, ka mundësi të pashtershme por mungojnë investimet, kështu që le të jemi në të parët që investojmë për të marrë benefitet e këtij thesari të çmuar të natyrës Shqipëtare”*

Gjetjet

- Energjia e Rinovueshme është koncept relativisht i ri për komunitetin e pesë Njësive të Qeverisjes Vendore dhe njohuritë për këtë fushë janë të kufizuara.
- Roli i OSHC-ve është pak i ndjeshëm në ndërgjegjësimin e komunitetit për të qënë partner me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe investitorët për zhvillimin e projekteve në drejtim të Energjisë së Rinovueshme.
- Në përgjithësi Njësitë Vendore kanë informacion të përgjithshëm, por mungojnë ekspertët që njohin potencialet e burimeve të rinovueshme të enegjisë dhe mundësitë e zhvillimit të tyre.
- Mungonë literatura për fushën e Energjisë së Rinovueshme për t'ju ardhur në ndihmë goftë të ekspertëve, komuniteti, stafit të Bashkisë/Komunës, të cilat mund të shërbejnë për iniciativa të ndryshme.
- Edhe pse Njësitë Vendore e shohin me interes zhvillimin e Energjisë së Rinovueshme, ky interes nuk pasqyrohet në dokumentin financiar të tyre, që është Buxheti Vjetor i Bashkisë/Komunës.
- Biznesi privat nuk e shikon Njësinë Vendore si partner më kapacitetet e duhura profesionale në orientimin drejt burimeve më të përshtatëshme të Energjisë së Rinovueshme në atë zonë.
- Konsultimet publike nuk janë praktik e zakonshme për rastet e zbatimit të projekteve të Energjisë së Rinovueshme, në këtë mënyrë komuniteti nuk informohet për rëndësinë e zhvillimit dhe përfitimeve të këtyre energjive.
- Në rastet kur komuniteti ka ushtruar të drejtën e tij vendim-marrëse për projekte konkrete (rasti i Hidrocentralit të bunecit), ka patur përfitime në dobi të komunitetit (rikonstruktimi i rrugës së fshatit dhe ndriçimi i saj).
- Mungojnë politikat promovuese për të tërhequr donator të ndryshëm në fushën e Energjisë së Rinovueshme për të shfrytëzuar burimet e shumta të kësaj energjie në këto zona.
- Edhe pse në mungesë të një orientimi të qartë nga Njësitë e Qeverisjes Vendore apo Qëndrore, ka patur raste sporadike të iniciativave private për shfrytëzimin e energjisë diellore.

- Si pasojë e mungesës të një investimi serioz strategjik për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në këtë zonë, bizneset turistike e shohin me shumë interes zhvillimin e iniciativave për shfrytëzimin e burimeve të Energjisë së Rinovueshme.
- Përfaqësuesit e njësive të qeverisjes vendore mendojnë se ato mund dhe duhet të japin kontributin e tyre në konsultimet publike për hartimin e ligjeve në fushën e Energjisë së Rinovueshme.
- Megjithëse ka potencial të mjaftueshëm të biomasës në këtë zonë, mungojnë politikat koordinuese për shfrytëzimin e saj në dobi të prodhimit të Energjisë së Rinovueshme.

Rekomandime

- Të rritet fryma e bashkëpunimit midis pushtetit lokal dhe grupeve të interesit, shoqërisë civile lokale, bizneseve private dhe të gjithë komunitetit, duke krijuar marrëdhënie të qëndrueshme midis tyre.
- Krijimi i marrëdhënieve të qëndrueshme dhe bashkëpunimi afatëgjatë për zbatimin e projekteve me ndikim në mjedis midis Pushtetit Lokal dhe Organizatave të Shoqërisë Civile.
- Realizimi i fushatave sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere për grupet e interesit, të rinjtë, biznesin dhe qytetarët për të nxitur ata që të ushtrojnë të drejtën e pjesëmarrjes në vendim-marrjen lokale.
- Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për të mirat që sjell përdorimi i burimeve të rinovueshme si nga ana financiare edhe nga ajo mjedisore. Fushatat ndërgjegjësuere mund të bëhen me mënyra të ndryshme, si p.sh. spotet publicitarare në mediat lokale dhe qendrore, fletëpalosje, etj.

- Të mundësohet akses për informacion në lidhje me planet dhe programet e Pushtetit Lokal në përgjithësi dhe për energjinë e rinovueshme në veçanti për të gjithë grupet e interesit, biznesit, qytetarët e interesuar, dhe shoqërinë civile në formën që i përshtatet më mirë pushtetit lokal.
- Organizimi i sesioneve të konsultimit publik midis vendim-marrësve dhe grupeve të interesit, të rinjve, biznesit dhe qytetarëve për të përfshirë mendimet, sygjërimet dhe idetë e tyre në planet, projektet dhe programet lokale të zhvillimit.
- Publiku të ketë akses për burimet ekzistuese të energjisë së rinovueshme në njësinë përkatëse vendore, kapacitetet e shfrytëzimit të tyre dhe mundësitë që ofrojnë këto burime për komunitetin.
- Njësitë e qeverisjes vendore të mbështesin dhe të inkurajojnë bizneset private të cilat janë duke zëvendësuar përdorimin e energjisë elektrike me atë kryesisht diellore (hotelet përdorin panalet diellore për ngrohjen e ujit), me anë të incentivave financiare apo shtimit të sipërfaqes së paneleve për ta shtrirë shfrytëzimin e energjisë diellore edhe për ndriçim apo aktivitete të tjera.
- Marrja e masave të nevojshme nga ana e Qeverisjes Vendore për të siguruar cilësinë e përshtatshme të ujit që nevojitet për panelet diellore me qëllim që të ruajë jetëgjatësinë e paneleve diellore. (Rasti i Himarës ku uji është gëlqeror)
- Njësia vendore të koordinojë veprimet me institucioneve tjera publike por edhe me donatorë të huaj dhe vendas për të bërë të mundur ofrimin e kurseve trajnuese për të rinjtë për të siguruar montimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e paisjeve të cilat shërbejnë për sigurimin e energjive të rinovueshme.
- Nxitja e projekteve të vogla por efikase në fushën e energjisë së rinovueshme nga donatorë të huaj ose vendas të cilat do të shërbejnë si një shembull pozitiv për të gjitha grupet e komunitetit.

- Kryerjen e studimeve të mirëfillta duke përdorur kapacitet lokale dhe kombëtare në zona që kanë potenciale të mëdha për zhvillimin e energjive të rinovueshme duke synuar dhe tërheqjen e investitorëve të huaj apo vendas.
- Përfshirja në Buxhetin vjetor të Njësive Vendore (me një vlerë prej 10% të buxhetit) të një zëri të veçantë të destinuar për fushën e Energjive të Rinovueshme duke favorizuar zhvillimin e tyre në nivel lokal.
- Organizimi në mënyrë periodike të tyezave të rrumbullakta / seminareve / trajnimeve mbi çështjet e Energjive të rinovueshme, në bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Agjensinë Kombëtare të Burimeve Natyrore për qytetarët, grupet e intersit, pushtetin lokal, etj.

Bibliografia

<http://www.akbn.gov.al/>

<http://energy.gov/science-innovation/energy-sources/renewable-energy>

<http://www.britannica.com/EBchecked/topic/17668/renewable-energy>

<http://www.al.undp.org/albania/en/home.html>

<http://www.theguardian.com/environment/renewableenergy>

<http://energija.al/>